

# Relacion Teknik

**Objekti: “Zgjerimi i ndricimit rrugor ne fshatra”**

## **1. Nje veshtrim mbi ndricimin ne fshatrat e Bashkise Gjirokaster:**

Si pasoje e investimeve te pakta nga ana e Bashkise Gjirokaster gjendja e ndricimit rrugor e fshatrave ne jurifiksionin e saj ka ardh nga viti ne vit te perkeqesohet, duke evidentuar shume defekte dhe realisht nje ndricim jo te mire;

Ne kete gjendje ka ndikuar edhe financimi nga buxheti shtetit, jo me per linjat e fshatrave por dhe te furnizimit qendror me energji, por fale investimeve te fundit te kesaj qeverie, kjo ka ndryshuar pozitivisht duke rritur treguesit e energjise elektrike ne zone; ndersa per ndricimin e rjetit te fshatrave te kesaj Bashkie ende nuk ka asnje lloj investimi;

Fale nje perkujdesje te perviteshme te ekipit te elektricisteve te Bashkise Gjirokaster, me masat e vazhdueshme te marra, eshte realizuar nje mirembajtje e perkohshme e ketyre linjave, por eshte e pamjaftueshme per te siguruar nje gjendje te mire te ndricimit te gjithe fshatrave te Bashkise Gjirokaster;

Duke bere nje vizite ne te gjitha qendrat e fshatrave, ekipi elektrikist i Bashkise Gjirokaster, evidentoi situaten e ndricimit, evidentoi ne vend gjendjen e tij dhe parashikuan masa per permiresimin e tij, duke bere prezent te gjitha nevojat qe sistemi ka aktualisht;

Ne kuader te masave per permiresimin e sistemit te ndricimit te disa fshatrave te Gjirokasters, mbi bazen e planit te investimeve te miratuar te vitit 2019, organizohet edhe ky investim, me synimin e ndryshimit sadopak te gjendjes se ketij sistemi;

## **2. Masat per permiresimin e ndricimit te fshatrave te Bashkise Gjirokaster:**

Hartimi i nje projekti elektrik per permiresimin e sistemit te ndricimit, duke e kompletuar me te gjitha elementet e nevojshem te tij, projekti zbatimit, detajet elektrike, ky relacion sqaruas i procesit, specifikimet teknike te zbatimit te punimeve elektrike per gjendjen dhe dokumenta te tjera shoqeruese te projektit;

Hartimi i preventivit te punimeve elektrike te mbeshtetura ne manualin e çmimeve te vitit 2015, sipas VKM Nr.629, date 15.07.2015, qe aktualisht eshte ne fuqi;

Analizat teknike qe nuk jane ne VKM Nr.629 jane hartuar sipas librit Nr.6 “Montimi i linjave dhe te nenstacioneve” dhe te atij te “Normave komunale”, sipas udhezimit Nr.2, date 08.05.2003 ne mbeshtetje te Ligjit Nr.8402, date 10.09.1998;

Ne kete preventiv punimesh elektrike jane perfshire fshatrat: Fushe Bardhe, Humelice, Mashkullore dhe Zhulat. Theksojme se edhe ne keto qendra fshati nuk jane perfshire te gjithe nevojat e evidentuara, por nje pjese e tyre, qe alternon ne total ne 70% te sasise se domosdoshme per kompletimin e tyre.

Per te siguruar nje permiresim te mjaftueshem te sistemit te ndricimit ne kuader te ketij fondi e projekti jane perfshire: furnizim e montim ndricues LED 100W, 230V, furnizim e montim krah dy degesh per shtylla metalike per ndricim, furnizim e montim kuader komandimi komplet me santeri, fotoelement dhe "Rele Muzgu", furnizim e montim kablllo "ABC" Al S=2x16 mm<sup>2</sup>, furnizim e montim kabell  $\Phi$ 2.5 mm per lidhje pergjate shtylles dhe furnizim e montim kabell 2x1.5 mm.

**Projektoi:**

**Ing. Spiro NIKA**

